



► Mbledhja e Koordinatorëve
"Për Zbatimin e Planit të
Veprimit të Strategjisë
Kombëtare për Diasporën"



► Mbledhjet grupi
ndërinstitucional i punës për
përcaktimin e kordinatit të
kombëtar për programin e
bursave



► Grupi ndërinstitucional i
punës, diskutime për rrjetin e
informimit të diasporës

NEWSLETTER E DIASPORËS



AGJENCIA
KOMBËTARE E
DIASPORËS



FONDI SHQIPTAR
PËR ZHVILLIMIN E
DIASPORËS



QËNDRA E
BOTIMEVE PËR
DIASPORËN

#2

Miratohet vendimi për Organizimin e Samitit të Dytë të Diasporës

*Qeveria miratoi "Vendimin për Financimin dhe Organizimin e Samitit të Dytë të Diasporës",
të propozuar nga Ministri i Shtetit për Diasporën.*

Ky projekt akt ka rëndësi pasi ka për qëllim realizimin e aktivitetit më të madh ku do të marrin pjesë përfaqësues komuniteteve të shqiptare në Diasporë. Deri tani është parashikuar që të marrin pjesë një numër i madh përfaqësues të regjistruar nga të gjitha organizatat dhe komunitetet shqiptare nëpër botë.

Organizimi dhe aktivitetet zbatuese për realizimin e Samitit të Dytë të Diasporës i cili do të mbahet në periudhën 28 shkurt-2 mars 2019 janë në fazën përfundimtare.

Institucionet kryesore që do të merren me organizimin e Samitit të Dytë të Diasporës janë Kryeministria, Ministri i Shtetit për Diasporën, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare janë parashikuar në vendimin nr. 1 datë 12.01.2018 "Për miratimin e aktiviteteve dhe projekteve në kuadër të vitit Mbarëkombëtarë të Gjergj-Kastriot Skënderbeut", të Komisionit Shtetëror për Organizimin e Veprimtarive në Kuadër të Vitit Mbarëkombëtarë të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut".



**SAMITI I DYTË I DIASPORËS
28 SHKURT – 2 MARS 2019**



Publikohet buletini i vitit 2018 "Për masat e Planit të Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës"

Buletini i publikuar nga Agjencia Kombëtare e Diasporës është një raport i plotë mbi ecurinë e zbatimit të "Planit të Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018-2024". Ky publikim është vazhdim i reflektimit mbi veprimet e kryera nga administrata e shtetit shqiptar gjatë vitit 2018 për Strategjinë Kombëtare të Diasporës, ku përfshihen 72 masa për realizimin në kohë të qëllimeve të saj. Ky buletin periodik është një dokument publik për procesin e realizimit të masave, i cili do t'i shërbejë informimit të institucioneve përgjegjëse. Buletini i cili publikohet një herë në tre muaj kryen vlerësimin e veprimeve të institucioneve në trajtimin e masave për të cilat ato janë përgjegjëse, duke dhënë kështu një pasqyrë të plotë të aktivitetit dhe duke bërë transparente ecurinë e procesit.

Në linkun e mëposhtëm mund të lexoni buletinin e plotë:

<http://diaspora.gov.al/wp-content/uploads/2019/01/PLANI-I-VEPRIMIT-PER-ZBATIMIN-E-STRATEGJISE-KOMBETARE-TE-DIASPORES-BULETIN-2018.pdf>

Diskutimi mbi "Angazhimin e Diasporës në Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë"

"Angazhimi i Diasporës Shqiptare në Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë" është një nga pikat kyçe të Politikave Shtetërore për Diasporën, ndaj edhe puna për realizimin e këtij qëllimi mbetet një nga sfidat e mëdha të institucioneve dhe organizatave të angazhuara në këtë drejtim.

Për këtë arsye sot institucioni i ministrit të Shtetit për Diasporën në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin dhe Agjencinë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim (AICS) organizuan një seminar trajnimi. Gjatë fjalës së tij ministri tha se "Diaspora nuk është një çështje e izoluar por ajo prek të gjithë sektorët. "Realizimi i Strategjisë Kombëtare të Diasporës është një sfidë e madhe, shumë ambicioze", – tha ministri.



NIS PROCESI PËR
REALIZIMIN E PLATFORMËS
SË PROGRAMEVE QË DO
TË TRANSMETOHEN NË
RTSH DIASPORA



Grupi ndërinstitucional i punës për zbatimin e urdhrimit nr.180 të Kryeministrit "Për përgatitjen e platformës së programeve të emisioneve të posaçme për mësimin e gjuhës shqipe, kulturës shqiptare dhe identitetin kombëtar, të dedikuar për Diasporën" mbajti sot mbledhjen e radhës, ku u diskutuan disa nga pikat më të rëndësishme të këtij urdhri.

HISTORIA E DIASPORËS

SHQIPTARE, SË SHPEJTI

PAVIJON TË DEDIKUAR NË

MUZEUN HISTORIK

KOMBËTAR



Në takim të kryesuar nga Ministri i Shtetit për Diasporën përfaqësues nga ministrinë e kulturës, arsimit, turizmit, dhe punëve të jashtme u bisedua mbi strukturën që ky pavijon do të ketë. Ministri i Shtetit për Diasporën u kërkoi përfaqësuesve të ministrive, propozimet përkatëse për ndërtimin e të parit pavijon historik dedikuar Diasporës shqiptare.

2019-ta viti i aktiviteteve kulturore shqiptare në Diasporë

Grupi ndërinstitucional i punës për zbatimin e urdhrin nr.138/2018 të Kryeministrit, për zbatimin e masave 2 dhe 45 të "Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën" mbajti sot mbledhjen e radhës. Në takimin e drejtuar nga ministri i Shtetit për Diasporën u diskutua për zbatimin e urdhrin nr.138 të Strategjisë Kombëtare të Diasporës. Qëllimi i punës së këtij grupi është krijimin e një kalendarit aktivitetesh të përbashkët shtetëror në funksion të komunitetit shqiptarë në Diasporë.

Ministri i Shtetit për Diasporën, z.Pandeli Majko tha gjatë takimit se është domosdoshmëri përcaktimi sa më shpejt i një koordinatori kombëtar i cili do të bashkërendojë aktivitetet për promovimin e Shqipërisë në vende të ndryshme të botës ku jetojnë komunitetet shqiptare.

Zv.ministria e Turizmit dhe Mjedisit znj. Ornela Çuçi tha se ky institucion ka miratuar një listë me aktivitete, për realizimin e panairëve në qytete të ndryshme të botës për promovimin e kulturës, traditës dhe kulinarisë shqiptare.

Gjithashtu u diskutua edhe promovimin e Shqipërisë, nëpërmjet projekteve "Smile Albania" dhe "100 fshatrat", një nismë e cila ka për qëllim afrimin e shqiptarëve të Diasporës me vendlindjen, duke servur aktivitete kulturore në qytete të ndryshme në ditë të shënuara për komunitetin.

